



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal of Kacanik
01Nr. 60/01-4832/22
Kaçanik, 28.02.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e II (dytë) e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2022 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 28 shkurt 2022. Mbledhja është mbajtur në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 27 anëtarë, të gjithë.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkyryetari i Komunës, Sabedin Vishi, Drejtori et drejtore: Qamil Stagova, Dardana Taflili-Dauti, Hafize Sallahi, Sali Malsiu, Suhad Dullovi, Bahri Selimi dhe Ramadush Osmani, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Hidajete Guri, Bejtulla Dalloshi, Fatlume Guri-Selimi dhe Arbnora Kuka.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Telprezencës nga Gëzim Sahiti-Zyrtarë i lartë për monitorim të komunave në MAPL.

Mbledhjen e kryesoi Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
 Procesmbajtëse Makfire Malsiu.

Kryesuesi i Kuvendit z. Kemal Mërseli: Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu pëershëndet të gjithëve iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj pjesëmarrjen duke i thirrur emër për emër, kushte pune për t'u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e II-të (dytë) të rregullt të kuvendit të komunës për vitin 2022, data 28 shkurt, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2021;
3. Informatë e Zyrës së Personelit për menaxhimin e burimeve njerëzore për periudhën Janar-Dhjetor 2021;
4. Raporti Vjetor Financiar për periudhën: Janar-Dhjetor 2021;
5. Propozim Vendimi për themelin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” SH. A – Njësia Kaçanik;
6. Propozim Vendimi për themelin e Komisionit Komunal të aksionarëve për NKP “Stacioni i Autobusëve” SH. A- Kaçanik;
7. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik, pjesën e PK Nr. 00433-0 ZK Duraj, për këmbim me pronën kommunale, pjesën e PK 00453-0 ZK Duraj;
8. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e PK Nr. 00139-2 ZK Biçec, për këmbim me pronën kommunale, pjesën e PK 00162-0, ZK Biçec;
9. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik, parcelat kadastrale me numrat: 01306-2 dhe 01306-8, ZK Kaçanik i Vjetër, për shfrytëzimin e hapësirave shkollore;

10. Raporti vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm për vitin 2021;
11. Plani i punës së Komitetit për Komunitete, për vitin 2022.

Rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës.

APROVON

Rendin e punës në përbërje prej 11 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka lë të urdhëroj: Përvërejtje nuk u paraqit kush, atëherë Procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KK e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

APROVON

Procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit të Komunës e datës 28.01.2022 / Lënda: 01Nr. 60/01-2201/22.

Kryesuesi i Kuvendit: Para se të fillojtmë me pyetje dhe kërkesa, e kemi një kërkesë nga Kryetarit i Komunës për formimin e komisionit për ndarjen e banesave të banimit social. KK në legjislaturën e kaluar e ka marrë një vendim për formimin e komisionit për ndarje të banesave të banimit social, mirëpo MAPL e ka kthyer vendimin, me arsyetim se kjo është në kompetencë të kryetarit të komunës. Për këtë çështje, ia kaloj fjalën, Kryetarit të Komunës, Besim Ilazi.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi: Ashtu si e tha edhe kryesuesi, në legjislaturën e kaluar, KK, ka marrë vendim për formimin e komisionit për ndarje të banesave sociale, MPL-ja na e ka kthyer vendimin, me arsyetim se është e drejtë ekskluzive e kryetarit të komunës marrja e një vendimi të tillë. Banesa është në finalizim e sipër, andaj e kam ndier si obligim moral edhe një herë t'iu drejtohem i juve për hir të korrektësisë, transparencës dhe gjithëpërfshirjes të marrë miratimin tuaj. Kërkoj nga tre grupet më të mëdha politike me na i sjellë nga një emër për anëtar të komisionit. Kërkesën do t'jua përcjell, ndërkaq në afat prej 7 ditëve na i dërgoni propozimet.

Kryesuesi i Kuvendit: Tre grupeve me të mëdha politike, kërkesa iu vjen me shkrim nga kryetari i komunës, përgjigjen e jepni me shkrim. Kalojmë në pozicionin:

Pyetje dhe Kërkesa

znj. Kadrije Lika-Troni: 1. Pyetjen të cilën e kam ngritur në mbledhjen e kaluar për kanalin e ujitjes në f. Kovaçec, përgjigjen që e kam marrë nuk është e plotë, ku ndër të tjera thuhet: Mjete për vazhdimin e punës për këtë vit nuk ka të parapara, ndërkaq mbetet të shihet për vitin vijues së a ia vlen investimi varësisht nga sipërfaqja që përfshihen në projektin për ujite. Çështja se a ia vlen investimi, është pikëpyetje e madhe, ai projekt është vital për ato toka dhe nuk ka hapësirë për kalkulime. Pyetje ime është: Kur përfundon projekti i kanalit të ujitjes në f. Kovaçec, i lënë në gjysmë ?

2. Të SHMP ‘Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka’, ujëmbledhësi është më lartë sesa niveli i asfaltit dhe gjatë reshjeve atmosferike krijohet pengesë e madhe për ngasësit e automjeteve, sepse të pengesa e shpejtësisë mblidhet uji. Është jo etike para SHMP të shihet një punë joprofessionale, kjo paraqet një imazh të keq për institucionin komunal.

z. Adnan Reka: E kam një kërkesë për ju kryesueses; A mund t ‘na i dërgoni me shkrim mungesat e arsyeshme për seanca te rregullta të kuvendit. Unë e kam parasysh nenin 7 të rregullores thotë: (për shkaqe të justifikueshme) mund të mungoj. Është term i gjerë, çështja e termit, shkaqe të justifikueshme, andaj me na i sqaruar me qartë, kur mundemi të mungojm me arsyе në mbledhje të KK, me qëllim që të jetë për të gjithë e barabartë, të jemi transparent dhe mungesat të jenë për të gjithë të barabarta . Kërkoj përgjigje me shkrim.

Kryesuesi i Kuvendit: Nga koha që jam unë kryesues i KK, pavarësisht arsyeve; Covid-19, dhe raste tjera, asnë anëtar i KK nuk është kompensuar për mospjesëmarrje në mbledhje, për shkak së MAPL na ka thënë, pavarësisht arsys, kompensimi nuk i paguhet anëtarit nëse nuk merr pjesë në mbledhje. Askush nuk ka marrë mëditje nëse nuk ka qenë në mbledhje, për këtë jam shumë i sigurt. Unë kam bërë kërkesë MAPL përmes zyrtares së KK për çështjen e mungesave për shkak të infektimit me Covid-19. Përgjigja e tyre është së, anëtarët e KK e marrin paushallin që iu takon sipas ligjit, ndërkohë pa marrë pjesë në mbledhje nuk marrin kompensim. Kushdo që e ka ndonjë arsyë që ka munguar në KK, mundeni me iu drejtuar MAPL për këtë çështje dhe e merrni përgjigje.

z. Adnan Reka: Neve me na i dhënë përgjigjet se cilat janë arsyet dhe pa arsyet që mundemi të mungojmë, e pastaj kërkoj sqarim në MAPL.

Kryesuesi i Kuvendit: Kushdo që e ka ndonjë arsyë që ka munguar në KK, se nuk e jepin rregulloret arsyen, mundeni me iu drejtuar MAPL dhe merrni përgjigje. Ne mundemi me marrë një vendim këtu se cilat janë arsyet dhe pa arsyet, por nuk mundemi t’ia qëllojmë se na dalin përsëri arsyë tjera. Nuk ka asnë akt që i përcakton këto çështje.

znj. Ardit Rahmani: Nga disa banorë të f. Ivajë jam njoftuar për një takim që kanë pasur me kryetarin e komunës dhe drejtoren e DAP, ku iu është bërë njoftimi së Zyra e vendit në f. Ivajë në muajin mars do të mbyllët, dhe zyrtari që punon aty do të kaloj në komunë, për shkak të objektit të vjetruar dhe nuk i përbushë kriteret për kryerjen e shërbimeve administrative. Kërkesa e banorëve të atij lokaliteti ku shërbimet kryhen jo vetëm për banorët e Ivajës por edhe 5 lokalitetet përreth është që Zyra e vendit në Ivajë të mos mbyllët, por të rinovohet. Kërkoj nga komuna të kenë parasysh premtimin elektoral i cili është në interes të atyre banorëve. Banorët janë unanimi në kërkesën e tyre legitime, kur dihet se komuna ka edhe zyra tjera të vendit që funksionojnë.

2. Kërkesa e dytë apo pyetje: E ngriti një shqetësim për çështjen e qenve endacak , problem i kamotshëm që po merret secili nga ne, ku komuna deri tani është dashur të ndaj mjete për menaxhimin e kësaj situate. Nuk ka vend që nuk ka qen endacak dhe kjo paraqet rrezik për qytetarët e komunës. Hedhja e fajit nga ai lokal në atë qendror dhe anasjelltas është ndër vite, që po ju sjell pasoja qytetarëve, e që uroj të mos përfundoj me fatalitet, atëherë nuk dihet nga kush me kërkuar llogari. Cilat janë masat konkrete që ka marrë komuna, sepse ky problem është shumë i dukshëm, sidomos në kohën e dimrit ?

z. Bashkim Luma: Kam një kërkesë për Drejtoreinë Arsimit. Meqenëse arsimi është një nga shtyllat kryesore për funksionimin e mirëfilltë dhe progresin e një shoqërie të shëndoshë, ne kemi pak mekanizma të mbështesim këtë shtyllë. Kemi hasur në problematika dhe diskriminime në kriteret për ndarjen e bursave, të pika 1.2 ku thuhet aplikuesit duhet të janë studentë të UP në Kosovë. Kjo pikë duhet përfshijë secilin studentë nga komuna e jonë. Andaj kërkoj që kjo pikë e konkursit të ndryshohet, ashtu që pjesë e konkursit për bursa të janë edhe studentët që i ndjekin studimet në shtetet përreth.

z. Naim Beça: Fillimisht dha vërejtje për kushtet teknike në sallë, ndërkaq kërkoj për hera tjera salsa e KK të jetë me e ngrohur.

1. Kur do të përfundojnë projektet të cilat kanë filluar para zgjedhjeve, të cilat kanë mbetur në gjysmë, si: Asfaltimi i rrugës së qytetit, e shumë projekte tjera ?
2. Lidhur me pyetjen të cilën e kam ngritur për projektin e rrugës së f. Runjevë, nuk kam marrë përgjigje, andaj kërkoj një përgjigje me shkrim.

z. Agim Çaka: E ngriti një shqetësim në vendkalimin për këmbësor në rrugën e magistrale te lagjet: Çaka dhe Zeneli, e cila pjesë e rrugës paraqitet rrezik permanent për këmbësor, andaj drejtoria kompetente duhet të bëjë një zgjidhje të kësaj çështje. Gjithashtu kërkoj të bëhet një zgjidhje për çështjen e ndriçimit publik në atë pjesë.

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkesa tjera nuk ka, atëherë kalojmë në pikët tjera të rendit të punës:

2. Raporti i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2021;

Kryesuesi i Kuvendit: Është një raport i cili e përbledhë punën e ekzekutivit të vitit të kaluar, raporti nuk votohet, e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Po mundohem me i shprehur shqetësimet e mia në këtë raport pune. Te DUKMM-ja sektori i urbanizmit, te kërkosat për legalizim të objekteve, pika 3.1 thuhet së është punuar për regjistrimin e lëndëve në legalizimin e objekteve pa leje, është punuar regjistri i lëndëve të pranuar 2019-2021 gjithsej 50 lëndë. Kërkesa të pranuara në vitin 2021 321, të aprovuara 175, të dorëzuara në kadastrër për procedurë të mëtejme 175, kërkesa në pritje 32. Ku ka mbetur numri i 118 lëndëve që nuk janë aprovuar e që janë dorëzuar në kadastër për procedurë të mëtejme, as nuk janë refuzuar. DUKMM e cila bënë menaxhimin e shfrytëzimit të tokës dhe lokalet e komunës, të evidentuara janë 86 shfrytëzues. Për 51 shfrytëzues DU, ka lëshuar kontrata, të cilat i kanë kryer obligimet në DU, ndërkaq 35 shfrytëzuesve për shkak të mos shlyerjes së obligimeve janë dorëzuar në përmbarues privat. Pyetja, këta 35 lokale apo toka të komunës, a janë duke vazhduar të njëjtin biznes apo i janë dhënë në shfrytëzim apo janë të lira. Në kuadër të projekteve të DUKMM, rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve, janë implementuar dhe menaxhuar edhe 22 rrugica tjera me asfalt dhe kubëza 6444 m dhe 4 rrugica me shtresë zhavorri me gjatësi 1230.50m. këtu është bërë ndarja e rrugës. Raporti i ekzekutivit duhet të jetë i detajuar për ne dhe për qytetarët që me ditur me saktësi investimet nga buxheti i komunës. Të DSHPE, në kuadër të Memorandumit të mirëkuptimit me MAPL, me qëllim të implementimit të projekteve nga granti i përformances, kemi përfituar 145,266.5 €, është mirëpritur dhe janë implementuar 2 projekte në rregullimin e infrastrukturës rrugore. Me shumën e mjeteve janë bashkë-financuar projektet të rrugëve, rehabilitimi i rrugës Sali Bajra dhe Qamil Ilazi, Ndërtimi i trotuarit të rrugës Bob-Doganaj. Kur thuhet se nga GP kemi marrë mjete, me keqardhje e themi sesi janë menaxhuar dhe mbikëqyrë projekti i rrugës, Qamil Ilazi dhe Sali Bajra, kur dihet se nuk i plotësonjnë as kushtet minimale, ndërkaq dihet rëndësia e kësaj rruge. Mendoj se projektet duhet të janë të harmonizuara edhe në praktikë në bazë të standardeve, jo vetëm me letra, por të harmonizohen që ndoshta të bëjmë një përformancë të mirë, kur dihet se praktika është diçka tjetër. Të çështja e ujit, në rrugën Qamil Ilazi dhe Sali Bajra, thuhet së janë ndërruar gypat e azbest betonit.

Kryetari i komunës-Besim Ilazi: Sa i përket kontratave të komunës me lokale, siç u tha, 35 lëndë janë dërguar në përmbarues. Për momentin dhe atyre që janë borgj sipas rregullores nuk iu vazhdohet kontrata deri në një marrëveshje me palën ose përmes negocimit me rata. Nëse kjo nuk arrihet, atëherë shikohet forma tjetër, me i dhënë në shfrytëzim me pak së 1 vit

sipas rregullores. Për rrugë me kubëza nuk e di sa m2, m3, besoj që kjo mund të bëhet, sqarim me në detaj jep drejtori. Për deponi, është e vërtetë që nuk kemi që 20 vite, nuk kemi mbetur peng i këtyre deponive, se ka pasur pronar të cilët i kanë ofruar pronat e tyre dhe janë deponuar. Kemi bërë kërkesë të MPHMM para 2 viteve dhe nuk kemi marrë përgjigje për një hapësirë. Do të shikojmë edhe 1 herë me komunat; Shtërpçë dhe Hanit, për shkak se duhet numri i banorëve me qenë më i madh me na i dhënë ndonjë hapësirë. Të gypat e asbestit, çdo kund që po punojmë në qytet në rrugë, po i ndërrojmë. Ky problem është gati në krejt vendet e Kosovës edhe në kryeqendër, ndërkaq po bëjmë përpjekje që dita ditës me u ndërruar këta gypa Të DSHMS, është një kod 5.000€, ndarja e tyre është për ndihmë momentale, i ndajmë ndihma çasti si për mjekim etj. i kemi të dhënë, iu ndahen në bazë të raporteve mjekësore dhe gjendjes ekonomike, 100-200€, varësisht prej situatave.

znj. Kadrije Lika –Troni: Të DSHMS, vlen të theksohet se donacionet nga qytetarët kanë qenë mjaft të mëdha. I falënderoj për kontributin e tyre, sepse donacionet kanë ndikuar në shëndetin e qytetarëve të komunës. Gjithashtu të kjo drejtori është cekur së janë ndihmuar 30 familje, me shumën e ndarë 5000€. Cila është arsyaja e kësaj ndihme, në cilin muaj janë ndarë, në çfarë forme janë shpërndarë dhe cilat kanë qenë kriteret e përzgjedhjes ?

z. Qamil Stagova: Për Kërkesën e Naim Beça, përgjigjen ia dërgoj me shkrim, së me ka ikur kjo kërkesë. Të procesi i legalizimit, është e vërtetë se janë grumbulluar lëndë edhe në mungesë të stafit. Për numrin e lëndëve që janë mungesë, ato lëndë janë në procedurë. Lëndët të cilat janë në pritje, ligji e ka lejuar një natyrë të lëndës të cilat nuk i plotësojnë kushtet me u legalizuar për momentin, ato lëndë janë shqyrtuar, ndërkaq kanë ngelur në listë të pritjes për legalizim pas plotësimit të dokumentacionit për çështje pronësore juridike e të ngjashëm.

z. Agim Mani: Unë e di së nuk ke qenë në legjislaturën e kaluar, unë po flas në bazë të shënimeve, thuhet që gjatë vitit 2019-2021 janë nxjerrë të gjitha lëndët, të gjitha kërkesat e legalizimit, e që në gjithsej janë 500 lëndë

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, Raporti nuk votohet, kështu që konstatohet së Kuvendi i Komunës u,

Njoftua

Me Raportin e Ekzekutivit të Komunës për vitin 2021/ Lënda: 01Nr. 60/01-4535/22.

3. Informatë e Zyrës së Personelit për menaxhimin e burimeve njerëzore për periudhën Janar-Dhjetor 2021;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Te Informata e ZP, janë shpallë 51 vende të lira të punës, ndërkaq janë plotësuar 33 pozita, ndërkaq konkursi i fundit është në proces të zhvillimit të procedurave. Te arsimi, viti shkollor fillon në shtator, ndërkaq konkurset duhet të shpallen në muajin korrik dhe gusht, që me qenë të gatshëm për 1 shtator, ndërkaq këtu thuhet se nga 51 pozita 3janë plotësuar, 18 janë në proces të zhvillimit të procedurave. Kjo lënë hapësirë për keqpërdorim të konkurseve, ku ka pasur anulime dhe përsëritje të konkurseve.

z. Adnan Reka: Po të krahasojmë raportin e Zyrës së personelit dhe Raportin financiar, kemi një mos përputhje të madhe dhe unë mendoj së është jo pa qellim. Qëllimi është për të kamufluar të gjithë ata njerëz që janë të punësuar, por jo të evidentuar nga buxheti komunal. Sipas raportit financiar faqe 28, gjithsej kemi 766 të punësuar, ndërsa sipas raportit të

personelit gjithsej kemi 793 të punësuar, sipas RF ne arsim kemi 535, ndërsa sipas RP kemi 530, në shëndetësi sipas RF 107, ndërsa RP 98, në Administratën komunale sipas RF kemi 124 punëtore, ndërsa sipas RP 120 punëtorë. Dhe pyetja ime është, sa kemi të punësuarve për shërbime të veçanta, apo me kontratë mbi vepër, dhe atë nga cili vit, sepse nuk kemi të dhëna?

z. Hidajete Guri: Lidhur me pyetjen për 51 vende të lira të punës, janë shpallur, por nuk d.m.th. që procedura përfundon me shpalljen e konkurseve, ato munden me zgjatur, sepse të disa konkurse mund të mos plotësohen apo të mos kryhet procedura e vlerësimit të testimeve dhe ato procedura anulohen. Problemi ka qenë se jemi duke zhvilluar procedura të reja sipas ligjit për zyrtarët publik, ku sipas këtij ligji, drejtoria nuk merret me shpallje të konkurseve në arsim, por kjo kompetencë i takon PZ. Edhe procedurat kanë ndryshuar, tani zgjasim me shumë, në SIMBNJ është afati me i gjatë, 30 ditë shpallja e konkursit, pastaj fillon aplikimi prej 15 ditëve, kështu që jemi në një proces të tranzicionit dhe ndryshimit të legjisacionit. Numri i të punësuarve, është 793 në dhjetor 2021, për ndryshim prej 766 që është në raport financiar se nuk e kam pa qysh i ka përshkruar të dhënat. Të raporti i ZP janë përfshirë edhe 27 anëtarët e KK.

z. Agim Mani: Kemi shumë raste që konkurse janë anuluar, kjo lënë hapësirë për manipulime. Nëse kandidatët nuk i plotësojnë kriteret, konkursi anulohet në start e jo në fund. Kemi konkurse kur kanë përfunduar të gjitha procedurat, është kryer testimi me shkrim dhe me gojë, pastaj kur është ardhur koha me nënshkruar kontratën, konkursi është anuluar dhe ai konkurs nuk është rishpallë asnjëherë më.

z. Hidajete Guri: Nuk kemi asnjë procedurë që është kthyer nga organet që i shqyrtojnë. Kemi pasur ankesa edhe në Këshill të Pavarur Mbikëqyrës dhe ankesat janë miratuar në favorin tonë dhe nuk kemi asnjë procedurë që është kthyer nga këshilli apo gjykata.

Kryesuesi i Kuvendit: E mora fjalën, t'u dha përgjigja, replikave pastaj, diskutimi po kalon në bashkëbisedim. Nëse ke diçka tjetër Agim, urdhëroni;

z. Agim Mani: Kur një konkurs i kalon të gjitha procedurat dhe në fund anulohet kur të vjen koha me nënshkruar kontratën, këtu nuk është diçka në rregull. Unë e di rastin kur është anuluar konkursi pasi i ka kaluar këto procedura.

z. Hidajete Guri: Asnjë konkurs nuk anulohet nëse nuk vendos komisioni i ankesave, KPM apo gjykata. Nëse është fjala të shërbimi civil, asnjë procedurë nuk është anuluar pasi i ka kaluar procedurat, nuk e di nga e keni marrë atë informatë.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse dinë rastin konkret Agim, janë organet gjyqësore ku mund të drejtohesh.

z. Adnan Reka: Kjo mënyrë arbitrage e kryesuesit nuk është në rregull. Duhesh me pranuar edhe ju kryesues, kjo nuk është formë e mirë e drejtimit të seancës, nuk mundësh me ma marrë fjalën se ma lejon rregullorja.

Kryesuesi i Kuvendit: E bënë pyetjen e merr përgjigjen. Puna ime është me mbajte rendin e seancës.

z. Adnan Reka: Pyetje për shefen e personelit, Sa punëtorë i keni me kontratë në vepër ?

z. Hidajete Guri: Me ligjin për zyrtarët publik, kjo kompetencë i takon Zyrës së prokurimit. Nga hyrja në fuqi e ligjit nuk kemi të shpallur asnjë procedurë, apo të nënshkruar

ndonjë kontratë. Nëse ka punëtorë me kontratë në vepër, procedurat janë udhëhequr nga zyra e prokurimit.

z. Adnan Reka: A nënkupton kjo se nuk keni asnë të punësuar me kontratë në vepër ?

Kryetari i Komunës: E tha edhe shefja e personeli se nuk kemi asnë zyrtar me kontratë në vepër. Ata që kanë qenë me kontratë në vepër, puna me kontratë në vepër nuk lejohet mbi 6 muaj. Ka pasur punëtorë teknik për pastrimin e lumenjve etj. e dini edhe ju mirë. Nga 2019 nuk kemi punëtorë me kontratë në vepër, sepse procedurat shkojnë përmes prokurimit. Kur thoni se po kamufloni, është mirë me u bërë publike se ku kemi kamufluar, cilët persona i kemi kamufluar sipas jush, se është mirë me ditur ata të cilët na dëgjojnë, ne që jemi këtu dhe organet kompetente.

z. Adnan Reka: Unë mendoj se një raport i Zyrës së personelit duhet me pasur informata të mjaftueshme, përfshirë edhe punësimet me kontratë në vepër. Sa i përket kamuflimit, për derisa ka mos përputhje të raporteve, unë nuk mundem me quajtur ndryshe, kur ju nuk jeni kanë në gjendje me administratën e juaj me i harmonizuar këto shifra.

z. Ardita Rrahmani: Në emër të GP të LDK, e dënojmë ashpër sjelljen arbitrale të udhëheqjes se asamblesë së KK. Secili anëtar i KK e ka të drejtën e shprehjes se shqetësimit apo të opinionit lidhur me informatën.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse kam ndërhyrë unë në diskutimin e dikujt, kërkoi falje publikisht, por e di se kam bërë ndaj secilit tolerime me tepër sesa e lejon rregullorja. Unë po mundohem me iu përbajtj rregullores. Ju nëse ke ndonjë argument që unë kam bërë ndërhyrje, atëherë përmendi me emër ndaj kujt, së kam dëshirë me ditur që t'i kërkoi falje atij, përpos Adnanit që i kërkova falje me herët, nuk di së kam bërë ndonjë ndërhyrje. Qëllimi ka qenë për debat të mirëfilltë e jo të zhvillohet bashkëbisidim ne mes dy personave.

z. Ardita Rrahmani: Në mbledhjet e KK të cilat i kemi mbajtur deri me tanë, përpos subjekteve në opozitë, pa dashur me përmendor diskutimin e Adnan Reka, pozita nuk diskuton këtu.

z. Naim Beça: Ju jeni ai kryesor që e zhvilloni debatin kryesues. Ju po i përgjigjeni secilit anëtar të KK dhe po ia ndërprenë fjalën. Ne kur të bëjmë pyetjen, nuk mundet pyetja me qenë fikse dhe perfektë çdo herë, por gjatë marrjes së përgjigjes na kujtohen ende çështje që lidhen me pyetjen. Në rastin e Adnanit, mendoj se debati është pozitiv, sepse pyetja nuk është fikse dhe perfektë, edhe përgjigje nuk jemi duke marrë, andaj nuk është mirë me ngritur zërin.

z. Adnan Reka: Rregullorja nuk na i cenon të drejtën e debatit. Ne jemi me zhvilluar debatin e jo me mbyllur debatin. Ne, vendime nuk mundem me marrë se nuk jemi shumicë, ndërkaq së paku mos na i cenoni të drejtën e debatit.

Kryesuesi Kuvendit: Unë nuk jam për mos me ngjallë debat, por jo midis dy personave, se po kalon në bashkëbisidim debati. Nuk jemi na fajtor se ju jeni në opozitë, vendimmarjen e ka përcaktuar dikush tjetër- qytetarët. Nuk besoj që ndonjë KK që iu ka dhënë më tepër hapësirë me debatuar, keni pasur hapësirë e mjaftueshme dhe keni me pasur sa herë, por iu kisha lutur që debati mos të kalon në bashkëbisidim.

z. Adnan Reka: I lexoj rregulla të rregullores për punë të KK, nenin 31, për çështjet në diskutim lejohet replika. Replika lejohet çdo herë derisa të sqarohet çështja. Neni tjetër, koha për diskutim nuk zgjatë me tepër së 10 minuta, diskutimi për rendin e ditës nuk zgjatë mbi 2 minuta.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse e shikon me minutë, mundesh me pa vetën sa herë keni ndërhyrë në debatet e tjerëve. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatohet së Kuvendi i Komunës u,

Njoftua

Më aktivitetin e Zyrës së Personelit për menaxhimin e burimeve njerëzore për periudhën Janar-Dhjetor 2021 / Lënda: 01Nr. 104/02-4308/22.

4. Raporti Vjetor Financiar për periudhën: Janar-Dhjetor 2021;

Kryesuesi i Kuvendit: Fillimisht fjalën ia kaloj drejtorit, pastaj e hapi diskutimin.

z. Bahri Selimi: Raporti përgatitet sipas standardeve të MEF, për publikun, qytetarët për ju anëtarë të KK. Buxheti për vitin 2021 në total ka qenë 9,086,394.04 €. GQ është realizuar 99.41 %, mjetet kanë mbetur të IK dhe të MSH. Viti 2021 ka qenë vit zgjedhor, nevojë ka pasur për rishikim buxhetor, sepse të HVK janë tejkaluar, nuk kemi pasur seanca dhe ka mbetur ky buxhet. Të HVK janë me të larta në raport me planifikimin, tejkalim ka pasur të TP dhe të taksat për leje të ndërtimit etj. Shpenzimet: Pagat dhe Mëditjet janë 100% realizimi, MSH 97.68 % SHK 92%, Subvencione dhe Transfere 99%. IK me 85%. Realizimi i buxhetit sipas drejtorive janë paraqitur në tabel, pres ndonjë pyetje prej juve.

znj. Ardita Rrahmani: Të kategoria e subvencioneve dhe transfereve, në drejtorinë e zhvillimit ekonomik është bërë subvencionimi i ndërmarrjeve transportuese lokale. Në parim jemi në rregull me subvencione, mirëpo në bazë të cilave kritere është bërë kjo ndarje në shumë 8.800€.

z. Agim Mani: Pavarësisht rritjes së buxhetit komunal nga viti në vit, fatkeqësisht me tepër së gjysma e buxhetit shkon për paga dhe mëditje, apo 58.45%, 9.95% për mallra dhe shërbime, 2.18% për shpenzime komunale, 3.48% për subvencione dhe transfere dhe 26.35% për investime kapitale. Edhe pse me këtë buxhet të vogël, komuna ka ngelë me suficit 46.070€, të cilat mjete në vend që të shpenzohen për ndonjë projekt, i kthehen qeverisë. Edhe pse kanë mbetur shumë projekte të parealizuara, buxheti nga të HVK bartet nga viti në vit, të cilat mjete mbisin të pa shfrytëzuara. Në bazë të tabelës, të HVK janë: 646,655.00€ për vitin 2021, ndërkaq në vitin 2020 janë: 506,352.72€. Të hyrat nga grantet dhe të bartura nga donatorët dhe huamarria janë: 47,178.53€ e që në total bëjnë, 1,200,187.00€ dhe në këtë vit janë shpenzuar 814,115.97€, ndërkaq kanë mbetur pa shpenzuar edhe 386,071€, d.m.th me këtë buxhet kaq të vogël nuk është arritur të shfrytëzohen edhe këto mjete, ndërkaq dihen së kërkesat dhe nevojat e qytetarëve janë shumë të mëdha. Kam një pyetje, të inkasimi i të HVK, tabela nr. 2- Administrata e përgjithshme, të taksat për shtetësi, kanë qenë të planifikuara në vitin 2021, 1.000€, ndërkaq të realizuara 0 mjete, ndërkaq në vitin 2020 janë realizuar 5,201.55€. Ku qëndron arsyja e këtij dallimi ?

z. Adnan Reka: Unë kam vërejtje të shpenzimet për MSH, ku kemi 826,344€, në raport me Subvencione dhe transferet ku kemi vetëm 300,804€. Pastaj të tabela me nr. 7, përbledhja e MSH, shpenzimet e përfaqësimit dhe avokaturës, 8,520€. A nuk ka komuna përfaqësues ligjor që i mbulon këto shpenzime. Pastaj shpenzimet kontraktuese, 126,198€, çfarë shpenzimesh kontraktuese duhet të paguaj komuna, ajo duhet t'i ketë ekspertet e vet në të gjitha fushat, sepse pretendon t'i ketë. Shpenzimet e furnizimit me ujë dhe pije, 36,206€, ku kemi pirë apo ngrenë, këta që kanë qenë anëtarë e dinë, si Kadriu, se minden me na akuzuar anëtarët e rinj së këta nuk e dinë, sepse janë shumë mjete. Shpenzime e vendimeve të gjykatave, vitin që po diskutojmë kemi me pak 626€, kahasuar me një vit me herët që kishim 740,540€, por jo, sepse po t'i shikoni faqen 23, detyrimet kontingjente, ju mund të

kuptoni shumë lehtë së çka e pret komunën tonë, sa para ka me i paguar komuna për përbartues. Dhe, shpenzimet kapitale nga të HVK e kemi të banesa sociale, për të cilën dua ti them kryetarit, së kësaj radhe dua ti informoj qytetarët së para dy muajsh u diskutua raporti finansiar nëntëmujor dhe me thatë mos i dezinformo qytetarët, e unë iu thash së ende jemi ne këtë kuvend dhe kemi kohë t'i informojmë qytetarët, e unë sot dua t'i informoj qytetarët. Në vitin 2017, 343.974€ ne vitin 2018, 34.397€ ne vitin 2019, 78,515€ dhe me vendim te kuvendit te datës 16.04.2021 keni transferuar 160.000€ për ndërtesën për banim social, e cila deri me tanë ka kushtuar 616,887€ për 24 banesa., e që i bie një banesë në Kaçanik të Vjetër ka kushtuar (për të ndërtuar, jo për të shitur), 25.700€ dhe atë, pa paguar tokën, lejen apo taksën ndërtimore. Duke marrë parasysh këto, unë nuk mundem me u pajtuar me këtë raport finansiar.

Kryesuesi i Kuvendit: Të Zyra e kuvendit, shpenzimet për ushqim dhe pije, 2.262 €, iu siguroj se përpos një drekë zyrtare për inaugurim të KK, shpenzimet e bufesë për KK dhe për komisione që formohen nga KK, nuk është bërë ndonjë shpenzim tjetër. Mjetet e planikuara nuk janë shpenzuar të gjitha dhe ka lindur nevoja për bartjen e tyre. Janë bartur nga ZK në dikastere tjera të administratës komunale, se ka pasur mungesë të mjeteve.

Kryetari i Komunës: Në mbledhjen tjetër do të sjell shifrën e sakë të shpenzimeve për banesën sociale, se po të garantoj se shifrat që i thoni ju nuk janë të sakta. Nëse thirreni në kontratatë cilat i keni nënshkruar është tjetër, nëse thirreni në shpenzime të realizuara është diçka tjetër. Shuma 600.000€ kam thënë së i ka ndarë MSHMS, por nuk janë shpenzuar, ju fort mirë e dini këtë çështje. Unë në mbledhjen tjetër të demantoj saktësisht sesa mjete janë shpenzuar dhe të garantoj se nuk kanë me dalë shumat që po i thoni ju. Sa mjete janë ndarë mundet me qenë, por sa janë shpenzuar, nuk dalin shumat që po pretendoni, këtë po ta garantoj para KK. Ju më demantoni në mbledhjen tjetër me argumente, ndërkaq unë i jap me shifra.

z. Adnan Reka: Pyetja ime, nëse mjetet e ndara me kontratë nuk janë shpenzuar, pse banesa sociale nga viti 2017-2022 nuk ka përfunduar? Atëherë kryetar në mbledhjen tjetër m'i ofroni të dhënët lidhur me shpenzimet për banesën sociale.

z. Bahri Selimi: Investimet kapitale (IK) 26.35% është totali i shpenzimeve të buxhetit, 58.48 janë shpenzuar për paga dhe mëditje. Në krahasim me kategoritë tjera, IK ka arsy që komuna iu jep prioritet. Nëse mundemi i shikoni raportet financiare të komunave tjera dhe e shihni se ne jemi me përqindje me të madhe të realizuar të IK. Të MSH të avokatura, ne e shfrytëzojmë ligjin e përbartimit dhe e angazhojmë përbartuesin privat në bazë të ligjit përbartimore në çështjen e borgjeve. Janë shpenzuar të DBPZHR disa gjoba të përbartuesve të pyjeve, krejt 8099 € i ka shpenzuar kjo drejtori. Kodet të shpenzimet e avokaturës nuk ndërrohet, kështu hyjnë shpenzimet e përafërtë. Shpenzimet kontraktuese tjera, janë disa shpenzimeve që nuk munden me u specifikuar, sigurimi i objektit teknik, zëvendësimi i stafit të DA, ku drejtoria ka kërkuar zëvendësim të stafit, mjetet janë në MSH. Kemi pasur një marrëveshje me MPMS për disa praktikantë, 3375€ ka kushtuar komunës këto punësime, 628 € është një përbledhje për aktivitetin e KK që e ka bërë shumë të mirë kryesuesi, 10404 € mirëmbajtje e hapësirave publike. Drejtori është këtu, janë bërë do marrëveshje me Pastërtinë në të mirë të qytetarëve të komunës. Institutit i shkencës dhe teknologjisë i kemi paguar diçka për rrjetin e internetit, janë paguar nga 4900 €. Të DU kemi paguar diçka, 6875 € kontrata për punë specifike, ka punëtorë që nuk ka asnjë, por kontrata për punë specifike ka është me prokurim. 6875 €. Meremetimi i objekteve 1390€, 13.520€ mirëmbajtja e rrugëve, 1332€ pajisje me pak së 1000€, pako ushqimore 3182 €, rregullimi i sallës 4021€, shënjimi i rrugëve 1000 € dhe tjera 3279 € të pa definuar. D.m.th plani kontabel përfshinë shumëçka. Plani i MF i përbledhë disa shpenzime. Të ushqim e pije, këtu hyjnë

bufeja e zyrës së kryetarit, nën kryetarit, drejtoritë, vetëm për bufe janë 9.000 €, këtu hynë edhe ZK, krejt tjerat janë pako ushqimore që iu janë ndihmuar familjeve në nevojë si rezultat i pasojave të pandemisë. Zyra e KK nuk i ka shpenzuar krejt mjetet 2200 €. Ne kemi shpenzuar mjete për pako ushqimore, d.m.th. nuk kanë shkuar për bufe mbi 10.000 €, ndërkaq tjera kanë shkuar për pako ushqimore. Në vitin 2020, 84750€ janë shpenzuar për pako ushqimore. Vendimet e gjykatave, në vitin 2021 janë 626 €, në vitin 2020, 740540 €. Kjo është kontrata kolektive në arsim që janë kompensuar arsimtarët dhe një pjesë e shëndetësisë nga fondi rezervë. Raportet të cilat i sjellim këtu, ne i procedojmë vetëm shpenzimet, por jo edhe planifikimet. Në vitin 2021, janë shpenzuar 153354€ për banesën sociale. Për me ditur sesa mjete janë shpenzuar për banesën sociale, duhet shikuar raportet financiare të cilat i kemi shpalosur çdo vit, të dhënët janë publikuar sa herë në raport.

z. Adnan Reka: A ka kontratë për mjetet e paguara për banesën sociale ? Këtë shqetësim po e ngriti, sepse kemi pasur raste, si të shkolla e Kovaçecit, ku pa procedura iu ka dhënë edhe disa mijë euro njerëzve në arrest shtëpiak për krime ekonomike.

z. Bahri Selimi: Me kontratën merret Zyra e prokurimit. Këtë shqetësim do të bartim tek organi kompetent, nëse nuk është e publikuar kontrata, e publikon ose ua sjell juve.

Kryetari i Komunës: Nuk ia kemi dhënë ne njeriut që është në arrest shtëpiak, por ia ka dhënë ligji në bazë të kritereve, se çka ndodhë pastaj me kontraktuesin, nuk i udhëheqim ne ato procedura.

z. Adnan Reka: Ju atëherë keni thënë kryetar, për operatorin që nuk i ka kryer punët duhet me dënuar dhe nuk merr asnjëherë tender dhe pas gjithë parregullsive, i keni dhënë punë, krejt Kaçaniku e dinë se 17.000 € i janë dhënë.

Kryetari i Komunës: Për ato 17.000 € që po thua janë dhënë, unë nuk e di qysh janë dhënë. meqë kjo lëndë është në krime etj. atëherë e jepin fjalën ato organe, se i kanë të gjitha dëshmitë, ndoshta ju nuk i keni të gjitha dhe ata i jepin parregullsitë. Ne kur ia kemi dhënë tenderin, nuk e kemi ditur se ai pas një viti ka me hyrë në burg,, plus asaj kompania është e djalit të tij, dhe nuk mundesh me ndal mos me aplikuar, se me letra ka qenë i përgjegjshëm.

znj. Arditia Rrahmani: Kërkoi përgjigje në pyetjen për subvencionimin e ndërmarrjeve transportuese lokale. Pa e gjykuar një vendim të legislaturës së kaluar, unë e di së këto biznese kanë punuar gjatë gjithë kohës, nuk e di sa ka qenë i arsyeshëm një vendim i tillë.

z. Bahri Selimi: Lidhur me pyetjen e Arditës, ne nuk kemi pasur mundësi me i ndihmuar të gjitha bizneseve, e kemi marrë një kërkesë më shqetësuese të një veprimtarie që kanë pasur më së shumti nevojë. Kompanitë transportuese publike: autobusët dhe kombinueset, gjenden në vështirësi të lartë, është marrë një vendim për ndarjen e 15.200€. Ata që kanë vija janë subvencionuar diku 1600 €, se pyetja është sa iu ka ndihmuar qeveria këtyre bizneseve, se është bërë fjalë mos me ushtruar veprimtaritë këto biznese, kështu që pësonin qytetarët.

z. Ekrem Livoreka: Meqë kjo mbledhje ka pikë shumë, atëherë kërkoi të bëjmë një pauzë 15 minutë-she, kuptohet nëse janë të pajtimit edhe anëtarët tjerë të KK.

z. Agim Mani: Edhe unë jam për pauzë, por të përfundojmë njëherë këtë pikë. E kam një pyetje për drejtorin e financave; Të administrata e përgjithshme, të HVK janë planifikuar 1000 €, të realizuara 0, kurse të vitin 2020 kanë qenë 5201 €, tabela 2.

z. Bahri Selimi: Kryesorja totali i te HVK është i pandryshuar, duhet me pyetur ish drejtorin e administratës, nuk jam i sigurt, me duket se kemi pasur tejkalim. Dallimi është i madh, mund të jetë ndonjë transfer nga niveli lokal në atë qendoror. Mundmi me kërkuar përgjigje të ish drejtori i administratës dhe ua kthen një përgjigje.

z. Kadrije Lika-Troni: Të subvencionet dhe transferet, janë 6100 € ndihma çasti dhe 5000 € për përfitues individual të DHSMS. Qysh janë dhënë këto mjete, a ka pasur kritere për të aplikuar qytetari me i marrë këto mjete, se kjo është ndihmë individuale, a është dashur me dërguar numrin e llogarisë dhe a është dashur të jenë raste sociale, qysh është procedura? Ndarja. 5000 € ishin subvencione në shëndetësi, ndërkaq 6100 € për çka janë paraparë?

z. Bahri Selimi: Nëse diçka me ikë, me plotëson kryetari, shuma 5000 € u sqarua për ato familje që nuk munden me u përballe me shpenzime jetësore, ndërkaq për shumën e subvencioneve: 6100€, duhet bërë kërkesë, afati zgjatë 15 ditë, duhet të jenë njerëz me kushte me nevojë të cilat kushte i vlerëson një komision, nganjëherë shikohet edhe gjendja në terren. Të gjitha janë ndihma çasti, është gati e njëjtë, iu ndahen 100-200€ për shpenzime jetësore.

Kryetari i Komunës: I njëjti destinacion është, ne kemi shkuar me ndarje të shumës 100 - 200 € për shkak të kushteve materiale, ata që kanë nevojë pavarësisht a merr social apo jo, për nevoja jetësore; dru, miell e të ngjashme, jo të gjitha për shëndetësi, por për nevoja jetësore.

z. Kadrije Lika-Troni: Unë d.m.th. mundem me i sugjeruar dikujt me ardhur të ju me i ndihmuar. Qysh është kriteri me marrë këtë ndihmë, se duhet me ditur edhe ne se çka duhet me plotësuar, se rastet sociale nuk mundesh me i ndarë së kujt me i dhënë mjete kujt jo.

Kryetari i Komunës: Kemi pasur raste edhe prej juve që është sugjeruar, unë kam thënë, lë të bënë kërkesën, ky është një fond që e ndajmë me mirëbesim. Nuk përjashtohet që nuk na ka ikur ndonjë rast, nëse ju e dini mund t 'na thoni. Qëllimi ka qenë human, me iu ndihmuar njerëzve. Nëse nesër ka ndonjë rast që ju e njihni se ka nevojë për ndihmë lirisht mund të na thoni.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë konstatohet së Kuvendi i Komunës u,
Njof tua

Me Raportin Vjetor Financiar për periudhën: Janar-Dhjetor 2021/ Lënda: 01Nr. 05-400/01-4717/22.

5. Propozim Vendimi për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” SH. A – Njësia Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: Komisioni themelohet prej 3 anëtarëve, 2 nga KK, 1 nga Ekzekutivi. Nëse nuk ka kush diçka, shkojmë me propozim konkrete për 2 anëtarë nga subjektet politike me të mëdha.

z. Fitore Vishi: Grupi parlamentar i PDK nuk ka propozim për këtë komision.

z. Agim Mani: Nga LVV ne propozojmë për anëtar të komisionit, z. Bashkim Luma.

z. Arditra Rrahmani: Në emër të GP të LDK ne e propozojmë për anëtare të komisionit, z. Arlinda Rakoci –Raka.

Kryetari i Komunës: Ne anëtarin e ekzekutivin e caktojmë më vonë.

z. Adnan Reka: Unë nuk di qysh mundemi ne me marrë vendim, pa e ditur anëtarin nga ekzekutivi.

z. Agim Çaka: Atëherë ne si KK i votojmë vetëm 2 anëtarët nga KK.

z. Agim Mani: Në propozim vendim shkruan se, vendimi hynë në fuqi pas miratimit nga KK, atëherë a nënkupton kjo së vendimi hynë në fuqi vetëm me këta 2 emra ?

z. Selajdin Troni: A kanë të drejtë anëtarët e komisionit me qenë në 2 komisione, sepse anëtarët nga LVV është edhe në një komision tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit: Në komisione kanë të drejtë, ndërkaq nuk kanë të drejtë ata që janë anëtarë të KPF dhe Komitetit për Komunitetet.

Kryetari i Komunës: Nga Ekzekutivi i komunës e propozoj për anëtar të komisionit, z. Ramadush Osmani.

Kryesuesi i Kuvendit: Propozimet për anëtarë të Komisionit komunal të aksionarëve për KRM “ Pastërtia” SH. A – Njësia Kaçanik i shtroj në votim për aprovim dhe u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM “ Pastërtia” SH. A – Njësia Kaçanik në përbërje:

1. Bashkim Luma, anëtar nga LVV,
2. Arlinda Rakoci –Raka anëtar nga LDK ; dhe
1. Ramadush Osmani, anëtar nga Ekzekutivi i komunës/ Lënda: 01Nr. 104/02-4209/22, Numri intern 681.

6. Propozim Vendimi për themelimin e Komisionit Komunal të aksionarëve për NKP “ Stacioni i Autobusëve” SH. A- Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: Edhe këtu kemi të bëjmë me një komision të natyrës së njëjtë, vetëm së kjo është ndërmarrje komunale. Komisioni do të jetë prej 3 anëtarëve, 2 nga KK, 1 nga ekzekutivi. Shkojmë me propozim konkrete:

z. Agim Mani: Nga PDK e propozojmë për anëtar të komisionit z. Rrustem Zenuni.

z. Agim Mani: Nga LVV e propozojmë për anëtar të komisionit, znj. Ernesta Krasniqi.

Kryetari i Komunës: Nga Ekzekutivi e propozoj për anëtar të komisionit, z.Murat Burrniku.

Kryesuesi i Kuvendit: Propozimet i shtroj në votim për aprovim dhe të njëjtit u aprovuan me njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për themelimin e Komisionit Komunal të aksionarëve për NKP “Stacioni i Autobusëve”

SH. A- Kaçanik, në përbërje:

2. Rrustem Zenuni nga PDK,
3. Ernesta Krasniqi nga LVV; dhe
4. Murat Burrniku nga Ekzekutivi i Komunës / Lënda: 01Nr. 104/02-4209/22
Numri intern 680.

7. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e PK Nr. 00433-0 ZK Duraj, për këmbim me pronën komunale, pjesën e PK 00453-0 ZK Duraj;

Kryesuesi i Kuvendit: Bëhet fjalë për këmbimin e pronës private me pronën komunale përrugë. Drejtori është prezent në mbledhje për me dhënë sqarime, e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Ky propozim vendim është me tepër në interes të individit që e ka parashruar kërkeshën, sesa me interes publik. Neve këtu si anëtar të KK po na shfrytëzon që t'i mbulojmë gabimet e ekzekutivit që i ka bërë me herët, sepse asfalti është shtruar në tokë private pa i kryer procedurat paraprake. Tani kërkohet nga ne që t'i përmirësoj gabimet e pushtetit. Ne nuk bëhem pjesë e këtyre gabimeve.

z. Agim Çaka: Nëse është e vërtetë së interes i është i individit, edhe unë nuk do të votoj këtë propozim vendim.

z. Rrustem Zenuni: Prona nuk është interes i individit që supozohet. Ne si fshat jemi për me i rregulluar rrugët në fshat. Ndërtimi i rrugës është bërë në vitin 2004 në aksionin e TMK. Në atë kohë ka qenë presioni i fshatit ndaj pronarit të pronës me lëshuar pronën, se nuk ka qenë e lehtë për pronarin se aty ka pasur edhe drunjtë. Presioni i fshatit nga administratorit është që kur ka interes fshati për rrugë të ngjashme me i lëshuar pronat. Nuk është vetëm ky rast, unë besoj së në mbledhjet vijuese do të kemi edhe shpronësimë tjera, jo vetëm në Duraj. Kërkoi nga kryetari dhe drejtori që të bëhet një planifikim, përfshirë edhe një kod buxhetor, ashtu që përmes zyrave të gjeodetve privat, të rregullohen këto çështje, jo vetëm për rrugë, për edhe për projekte tjera që iu kanë marrë pronat. Kërkoi që të votohet ky propozim vendim se është interes i përgjithshëm e jo interes i individit.

z. Adnan Reka: Unë nuk po e fajësoj askënd, por çështja është, pse nuk janë marrë fillimi sht veprimet paraprake

z. Rrustem Zenuni: Komuna ka filluar të funksionoj nga viti 2008 me Ligjin për vetëverisje lokale, e jo qysh mendohet që 20 vite, se kemi qenë në ndërtim të shtetit, dhe tani është mirë me i rregulluar do çështje të cilat na janë paraqitur. Pronari i kësaj prone ka bërë kërkesë që 13-14 vite dhe nuk janë marrë organet me këtë çështje. Sa për informacion, ai jep me tepër pronë sesa merr. Unë e kam ndërmend me u marrë me çështje të kësaj natyre të fshatit tim.

z. Agim Çaka: Unë e bëra një krahësim me propozim vendimin për këmbim të pronës në f. Biçec me atë të Durajt. Lënda e f. Biçec është mjaft e kompletuar, për faktin së është mbledhur këshilli i fshatit, e kanë diskutuar çështjen, kanë diskutuar edhe me pronarin se prona është në interes të fshatit, Këto veprime parapake është dashur të merren edhe të prona në Duraj, pastaj të adresohet kërkesa në organet e komunës dhe të vazhdoj tutje procedura.

Kryesuesi i Kuvendit: Pajtimi është i dyanshëm, ndërkaq interes i është më tepër publik sesa privat. Ne jemi këtu për me i shtyrë përpëra interesat publike të komunës, e sqaroj më në detaje këtë çështje z. Rrustem Zenuni.

z. Rrustem Zenuni: Kisha kërkuar nga anëtarët e KK të vizitojnë f. Duraj, e jo vetëm gjatë zgjedhjeve, dhe të shikojnë së prona në fjalë është në interes shoqëror. Për me i hequr dyshimet së prona nuk është interes individual, por jo vetëm këtë rast, por edhe rastet tjera të këmbimit, është mirë të vizitohen paraprakisht pronat në fjalë.

z. Adnan Reka: Nuk është e drejtë më na treguar neve së kur duhet bërë vizita në komunitete.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë propozim vendim e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 9 anëtarë (8 anëtarë nga LVV dhe Agim Çaka). Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e PK Nr. 00433-0 ZK Duraj, për këmbim me pronën komunale, pjesën e PK 00453-0 ZK Duraj /Lënda: 01Nr. 06-350/02-4567/22.

8. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e PK Nr. 00139-2, ZK Biçec, për këmbim me pronën komunale, pjesën e PK 00162-0, ZK Biçec;

Kryesuesi i Kuvendit: Edhe ky propozim vendim është i natyrës së njëjtë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Betim Shala: Unë këtë propozim vendimit e shikova, kjo ndryshon prej propozim vendimit të f. Duraj, së aty puna veç është e kryer qysh moti. Të ky rast, ne nuk e dimë se a parasheh PZHK që rruga me u ndryshuar prej këtij vend ku ka qenë dhe ku donë me u ndërtuar, së shpallja me interes e pronës duhet me iu përshtatur PZHK.

z. Fatmir Bunjaku: Për çështjen e f. Biçec, desha me cekur se vet jam aktivist dhe kam mbajtur takime dhe ne e kemi bërë kërkesë me na e mundësuar çështjen e këmbimit, se shumë më mirë na del rruga në atë pjesë, së e lidhë krejt fshatin Biçec. Kjo është si rrugë alternative edhe ne e kemi lutar pronarin me na mundësuar këmbimin, së është interes i krejt fshatit.

z. Adnan Reka: Ne, as për rastin në f. Duraj as për f. Biçec, në parim nuk jemi kundër, por jemi kundër mënyrës se si ekzekutivi po i udhëheq procedurat, pasi që së pari e ndëronton rrugën pastaj kërkon këmbim apo shpronësim. Ne themi së pari të jetë me PZHK, të bëhet studimi i fizibilitetit, pastaj procedurat tjera të shpronësimit apo këmbimit.

z. Fatmir Bunjaku: Të prona në f. Biçec ende nuk është asfaltuar rruga, janë vendosur pikat, është shtruar zhavorri, dhe presim miratimin e kuvendit, d.m.th janë marrë të gjitha parametrat paraprakisht.

z. Adnan Reka: Qysh po e shoh unë, fillimi shtruar janë marrë veprimet e dyta pa u marrë të parat.

Kryetari i Komunës: Ashtu siç je duke e kërkuar ju Adnan, janë marrë veprimet për këtë rrugë, ndërkaq është shtruar vetëm traseja e rrugës.

z. Agim Çaka: Pajtohem me idenë e Adnanit së duhet të merren fillimi shtruar janë marrë veprimet paraprake, pastaj me filloj me procedurat tjera. Në këtë çështje, drejtori i urbanizmit mundet me na dhënë sqarime më të hollësishme

Kryetari i Komunës: Po e qartësoj, rruga është, por për me ikur nja 100m me asfalt me shkurtuar rrugën, së është në interes të qytetarëve për rrugë me të shkurtër dhe në këtë rast po e kursejmë edhe buxhetin e komunës, kemi propozuar këmbimin e pronave.

z. Agim Çaka: Si procedurë e zhvilluar, me pëlqeu me tepër çështja e këmbimit në f. Biçec, sesa në f. Duraj, sepse çështja është diskutuar nga këshilli i fshatit, e kanë vlerësuar së është me interes të përgjithshëm, kanë biseduar me pronarin, pronari është deklaruar në komunë së pajtohet për me lëshuar pronën për interes të përgjithshëm. Ajo që thotë Adnani, është në rregull që komuna me i marrë veprimet paraprake, pastaj me vazhduar me procedurat, së po kërkohet me votu diçka që ka me u bërë pas marrjes së këtij vendimi. Mos e merrni çdo vërejtje të opozitës vetëm keq e nuk po donë me ecë përpëra komuna. Është mirë me pasur mirëkuptim, se jemi për me bërë punë të mira dhe të mbara për komunën dhe mos me pasur njerëzit probleme, me qenë interes i përgjithshëm prona dhe ai që e lëshon pronën për të mos pasur probleme.

Kryesuesi i Kuvendit: Të rasti i Biçecit, të rasti i Duraj çështja ka ndodhur, jo vetëm ajo rrugë, po ka pasur edhe raste tjera që janë shtruar rrugët, pastaj janë këmbyer pronat. Nuk është mirë që kanë ndodhur

z. Ramadush Osmani: Me kësot kërkesa kemi me u përball në vazhdimësi, nuk kisha me thënë së është sfidë për ju, por një mision që iu mbetet me përbushur. Çështjet pronësoro

juridike në Kaçanik dhe Kosovë janë të mëdha. Ne jemi duke u përballë më padi si komunë për investimet të cilat janë bërë para 20 viteve. Aty ku keni mundësi me këmbyer prona, ju me votën e juaj do të kurseni mjete buxhetore të komunës. Avokatet dhe gjykatësit e ndryshëm janë duke hyrë në gjeopartal dhe duke i shikuar rrugët e para 50 viteve, ju keni me pa edhe të "Dadini", që është paralufte, aty është një pronë private që ka me na ardhur padia që është para 70 viteve e asfaltuar. Aty ku keni mundësi me gjetur mirëkuptimin me këmbyer pronën e komunës me pronarin, do të jetë mirë. Aty ku keni mundësi me marrë deklarata që janë duke praktikuar, unë i kam 65 deklarata të pronarëve që deklarojnë së janë të gatshëm me hequr dorë nga pronësia, me qëllim që të bëhet rrugë, pa kompensim material. Këto nuk janë procese të lehta që na ndihmojnë në ekzekutim, sepse ka pronarë që kanë vdekur dhe trashëgimtarët e tyre janë të gatshëm me bërë ekzekutimin e projekteve, por pa i bërë do procese, shqyrtimi i trashëgimisë etj. ai projekt nëse i shkojmë këta hapa që po kërkohen, do të na vështirësonte punën jashtëzakonisht. Ne jemi duke punuar në tri forma, aty ku ka mundësi këmbimi, duhet ta bindim për këmbim, sepse është në interes të komunës, aty ku ka deklarata të qytetarëve që heqin dorë nga pronësi, do t' i shtojmë asetet e komunës, aty ku na padit, dihet se kanë më i fituar paditë, me arsyetim së janë shtruar rrugët pa një deklaratë ose pa nënshkrim të pronarit.

z. Adnan Reka: Rasti i Biçecit nuk është paralufte me shfajësuar dike. Një komunë serioze paraprakisht e orienton komunitetin, qytetarët, së duhet me iu nënshtruar procedurave qysh tha edhe Betimi se, a është prona në harmoni me PZHK, a mund të bëhet këmbimi apo jo, nëse jo, nuk mundet me u realizuar projekt. Me vjen keq, se nuk mundem me ndërtuar as rrugë qysh dojm ne si komunitet i vogël. Interesat e komunitetit duhet të janë në harmoni me interesat e përgjithshme të komunës, se nuk është mirë të inkurajojmë qytetarët me i aplikuar këto forma që me kaluar projekt i pronën e tyre, pastaj me ia paguar. Për me iu ikur parregullsive, ne duhet me i ndjekur procedurat, për këtë arsyë në parim do të abstenojmë, se nuk kemi qartësi të mjaftueshme në këto çështje.

z. Qamil Stagova: Duhet ta thjeshtojmë pakëz, problem është, por nuk janë bërë me qëllim, e pastaj të këmbehen. Dikush i ka lëshuar me dëshirë pronën, me vonë kërkon kompensim, ka edhe raste edhe me të hershme, këto veprime që po i marrim, janë në rregullimin e kësaj gjendje. Çka mundem me premtuar, projektet që bëhen tanë e tutje, me u zhvilluar procedurat paraprake, ndërkaq ato që kanë ndodhur deri tanë, kjo formë është me rregulluar gjendjen.

z. Adnan Reka: Çështja e rastit në Biçec, nuk është rast i vjetër, është rast i ri, numrat i keni dhe mund të vendosni,

Kryetari i Komunës: Për këmbimin e pronës në Biçec, është shtruar zhavorri, nëse votohet kundër, e heqim zhavorrin, dhe kthejmë në gjendjen e mëparshme. Mua me është dukur e arsyeshme këmbimi i pronës në fjalë, andaj e kam proceduar këtu.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim Propozim Vendimin: Rezultati i votimit ishte; shumica votuan Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 8 anëtarët nga LVV. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e PK Nr. 00139-2 ZK Biçec, për këmbim me pronën komunale, pjesën e PK 00162-0, ZK Biçec /Lënda: 01Nr. 06-350/02-4569/22.

znj. Ardit Rrahmani: Lidhur me pyetjen e Betimit, ne nuk morëm përgjigje.

Kryetari i Komunës: Të pyetja e Betimit, rruga është, vetëm ka me u zhvendosur për një 50m më lartë.

Kryesuesi i Kuvendit: Çështja u votua, mos të kthehem prapa, ishte i hapur diskutimi kush ishte i interesuar me marrë fjalën. Kalojmë në pikën vijuese;

9. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik, parcelat kadastrale me numrat: 01306-2 dhe 01306-8, ZK Kaçanik i Vjetër, për shfrytëzimin e hapësirave shkollore;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, drejtori ka një sqarim më në detaje.

z. Qamil Stagova: Këtu është fjala te shkolla fillore në Kaçanik të Vjetër, jo të shkolla e re që është në qendër të fshatit, por te shkolla afër ambulantes. Gjatë viteve 90-ta, pushteti i dhunshëm serb ka paraparë nga 7-8 parcelave të refugjatëve serb të Kroacisë. Ato prona kanë mbetur të regjistruala ashtu, 2 kanë kaluar në emër të pronarëve, kurse 6 tjera janë në emër të komunës. Për shkak të mundësisë së shitblerjes ne kemi parë të arsyeshme me i shpallë interes të përgjithshëm dhe këto prona me i kaluar komunës.

Kryesuesi i Kuvendit: Paraprakisht ne duhet me ditur së nëse e shpallim këto prona interes i përgjithshëm, duhet të përbushim obligimin ligjor për pagesën e këtyre parcelave. Sigurisht ato prona janë brenda oborrit të shkollës, meqë janë prona private duhet t'i kompensojmë, e mos të lëmë mundësinë me u shitur.

z. Naim Beça: Në emër të kujt janë ato 6 parcela, a janë të gjitha në emër të shqiptarëve dhe i kanë paguar taksa komunës pronarët e atyre pronave prej vitit 2000 e tutje.

Kryetari i Komunës: Jo Naim, një parcelë është në emër të një serbi-kroat, refugjatë që kanë qenë pas viteve 90-ta, kurse parcelat tjera janë pronë komunale. Parcela që po diskutohet sot, është rreth rrugës. Për këtë parcelë kemi menduar se është pronë komunale, nuk e kemi vërejtur, dhe kjo është arsy pse tani është në kuvend. Këtë parcelë e ka blerë një shqiptar, dhe një tjetër parcelë është aty afër. Edhe një parcelë është në emër të një serbi-kroat, refugjatë që kanë qenë pas viteve 90-ta. Tjerat janë pronë komunale. Objekt nuk ka pasur të ndërtuar, taksa të pronës në tokë nuk ka pasur, se nga viti i kaluar kanë filluar këto taksa. Pas lufte kush ku ka dashur ka ndërtuar dhe kush ka guxuar me i pyetur. Ka qenë e pa definuar, dhe na ka ikur kjo çështje, me çka edhe unë nuk pajtohem. Nga 6 parcela 2 janë të pronarëve serb, njëren e ka blerë dikush, dhe ajo na ka bërë më vërtetuar komplet atë parcelë dhe 2 pronarë janë në pjesën tjetër, për atë i kemi adresuar këtu.

z. Naim Beça, Çdo pronar i tokës duhet të paguaj taksë komunale, a kanë paguar ato taksa komunale?

Kryetari i Komunës, Besim Ilazi, Nuk kanë paguar, sepse nuk ka qenë e paraparë te taksa për token, prej vitit të kaluar kanë filluar pagesat për tokën.

z. Adnan Reka: Ne në parim jemi kundër këtij propozim vendimi, për shkak se kemi të bëjmë me shkelje ligjore në këtë rast, në vend së ta sjellin në kuvend vendimin e kuvendit të muajit mars apo prill të vitit 2021 për shpronësim të tokave private nga shtëpia e kulturës deri të xhamia e dëshmorëve, sepse edhe MMPH e kishte konstatuar së i vetmi autoritet për shpronësimin e pronave me interes publik është kryetari i komunës, ju na i sjelli përsëri propozim vendime kundërligjore për t'i kaluar përmes kuvendit, kjo është e pa pranueshme për ne. Organi shqyrtares e ka sqaruar shumë mirë, sipas ligjit nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme me ndryshim dhe plotësimin e ligjit 03/ L-25 ligji i ri i vitit 2010,

vetëm një organ shpronësues i përcaktuar nenin 3.1 ka të drejtë të bëjë shpronësimin e pronave të paluajtshme në Republikën e Kosovës. Sipas nenit 4.2, organ shpronësues është kryetari i komunës. Në bazë të gjithë kësaj që parashev ligji për shpronësimin e pronës së paluajtshme, kryetari i komunës nxjerrë vendime me të cilat propozon, inicion dhe kryen procedura për shpronësim në interes të komunës nga paragrafi 2. kompetencën e procedurës së pronave private të shpronësimit e ka kryetari i komunës.

Kryesuesi i Kuvendit: Vendimet për shpallje me interes të përgjithshëm publik dhe vendimet për shpronësim dallojnë njëra me tjetrën. Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik është e drejtë ekskluzive e KK. Propozim vendimi ka ardhur për shpallje të interesit publik. Në bazë të vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik pastaj kryetari i komunës merr vendim për shpronësim. Ky nuk është vendim për shpronësim, por vendim për shpallje me interes të përgjithshëm publik. Vendime të ngashme kemi marrë edhe më herët, si vendimi për lokacion të varrezave të qytetit, vendimi për stadiumit të qytetit. Të gjitha këto vendime, shpallja e interesit ka kaluar përmes procedurës së KK. Asnjë e drejtë e kryetarit nuk është më shpallë prona me interes të përgjithshëm publik, është e drejtë ekskluzive e KK. Propozimi vjen nga kryetari përmes drejtorisë, të cilët e vlerësojnë situatën. Procedura e shpronësimit janë procedura tjera të cilat bëhen me vendim të kryetarit edhe përcaktohen nga komisioni në nivel qendror nga Agjencia Kadastrave të Kosovës që përcakton vlerësimin e pronës dhe shumën e kompensimit. Këto janë procedurat ligjore të cilat duhet udhëhiqen, unë mendoj së janë ashtu, ndoshta dikush e dinë më mirë, por unë mendoj së janë kështu.

z. Adnan Reka: Duke marrë vendime të shpejta si të çështja e BK etj., e që kemi probleme të theksuara me qytetarë, për me i paraprirë vendimit tjeter që është i ndaluar, jo ne nuk pajtohem. Ne po e dimë qëllimin e vendimit, qëllimi është shpronësimi i pronës dhe ne nuk do të bëhem pjesë e këtij vendimi.

Kryetari i Komunës: Sipas juve Adnan, çka duhet me bërë? Kemi ardhur në një pozite, nuk mundemi me kthyer kohën prapa për 20 vjet. Ne duhet me zgjidhur këto probleme, se ne jemi këtu për me i zgjidhur ato.

z. Adnan Reka: E njëjtë situatë është sikurse shpronësimi i tokës për impiantin, janë shpronësuar 7 ha tokë për impiant e që Kaçanikut nuk i shërben aspak impianti.

Kryetari i Komunës: Të çështja e pronave për impiant, pronat janë private janë kompensuar nga komuna e Ferizajt. Komuna jonë nuk ka dhënë mjete dhe kanë përfituar fshatrat nga Elezaj, Duraj, Koxhaj, Semajë, të cilat fshatra komplekt kanë më u kyçur në impiant. Sipas juve ish asamblistët e KK kanë qenë të padishëm. Në kemi ardhur sot në një situatë, çështja është si me dalë nga kjo situatë, ndërkaq sipas juve nuk duhet me marrë asnjë veprim në këtë drejtim. Unë po e pranoj që është gabim i të kaluarës, por si me dalë kjo gjendje, e marrim një vendim, me shpallë me interes, pastaj merret vendimi i kryetarit për shpronësim, së ashtu kështu pala ta merr me gjykatë dhe komunës veç i rritën shpenzimet.

z. Adnan Reka: Gabimet të cilat i keni bërë vet, lani vet, si të çështja e hidrocentraleve etj. që jeni pajtuar edhe vet, se keni gabuar.

Kryetari i Komunës: Të hidrocentralet, ata të ministrisë me kanë thënë se janë marrëveshje shtetërore dhe nuk mundeni me i ndalu. Diçka çka është në letër me plane zhvillimore, nuk mundesh me i ndalë. Hidrocentrale janë ndërtuar edhe në vende tjera, si Pejë etj.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse dikush mendon së është bërë gabim që u ndërtua shkolla në atë lokacion në Kaçanik të Vjetër, unë mendoj së nuk kemi bërë gabim, edhe sot e kisha bërë atë

gabim, së ajo pronë është pronë e qytetarëve e jo e refugjatëve që i kanë pru aty. Mos i ndërlidh temën me hidrocentrale, se jemi duke folur për pronën të shkolla në Kaçanik të Vjetër. Në anën tjetër, debati po bëhet me 2 apo 3 personave, ndërkaq duhet t'i u epërt mundësia për diskutim edhe anëtarëve tjerë.

z. Betim Shala: Në emër të LDK-së, ne kemi vendosur që këmbimet e tokave me u votuar gjithnjë. Shpallja e zonës me interes publik, shpallet kur është e paraparë me PZHK, ose kur është një interes ekstrem i veçantë, siç është kjo të shkolla në Kaçanik të Vjetër, mirëpo arsyetimi mos me u bërë me 2 rreshta, përshkrimi lë të jetë ashtu siç duhet. Ne jemi duke votuar Për, por përshkrimi të bëhet siç duhet, së unë e di që shkolla në Kaçanik të Vjetër është e paraparë me PZHK.

Kryesuesi i Kuvendit: Për me u shpronësuar një pronë, së pari duhet të shpallet interes i përgjithshëm publik, pastaj i hapet rruga për shpronësim. Asnjë shpronësim nuk mundet me marrë kryetari nëse KK nuk e shpall pronë me interes të përgjithshëm publik.

z. Agim Çaka: Ne diskutuam për tri çështje për të cilat qëllimi ishte i njëjtë, ndërkaq specifikat janë të ndryshme. Të kjo e treta është me e komplikuar çështja, mirëpo unë si anëtar i KK do të isha me fat nëse arrihet me u rregulluar një gabim që është bërë para 20 viteve. Edhe pse po e shoh Adnan së nuk është në rregull, por më mirë me rregulluar tanë këtë çështje, sesa me ia lënë legjislaturës vijuese. Un jam duke folur në parim, nuk jam duke folur as si pozitë e as si opozitë, por jam duke folur në kuptimin e një anëtarit të KK i votuar nga qytetarët për zgjidhjen e problemeve. Po shihet se parcela është brenda shkollës, e shfrytëzon shkolla, çështja është e procedurave, së parcelat po figurojnë në emër të 2 personave të komuniteteve pakicë dhe është pak e komplikuar, se nuk e di saktë a i ka blerë kush këto prona apo jo, dhe çka është duke dashur personi, a është duke dashur me ia kompensuar me të holla apo këmbim, se po shihet së kjo është çështje e kryer.

z. Adnan Reka: Çështja e pronave aty veç dihet, emrin është shpronësim, shpronësimin duhet me e paguar.

z. Agim Çaka: Unë mendoj se problemet të cilat janë krijuar me herë, do të ishim me fat nëse arrijmë me i zgjidhur në mënyrën më të mirë të mundshme, por çështja është se, duke munduar me zgjidhur një problem që është krijuar me herët, mos me hyrë në ndonjë problem tjetër.

Kryetari i Komunës: Ky është shpronësim qoftë tanë apo para 10 viteve, se nuk ta ka falur, kjo është pronë e një pronari që tokën nuk ta ka falur, por duhet zgjedhur metodën. Metoda është me u shpronësuar, ndërkaq çmimi mund të jetë me ndryshe, po të ishte shpronësuar me herët, ndërkaq pse veprimet nuk janë marrë me herët, është diçka tjetër.

z. Agim Mani: Ne mendojmë së nuk janë përfillur procedurat paraprake, fillimisht është dashur të bëhet shpronësimi i pronës, pastaj të ndërtohet shkolla, e jo në këtë formë ku njëherë ndërtohet shkolla se pastaj të bëhet shpronësimi pronës, sepse të vënë në rrezik edhe objektin. Unë mendoj se nuk ka mbështetje të mjaftueshme juridike për këtë shpronësim, duke u thirrur në nenin 4 të Ligjit Nr. 03?L-139 të paragrafi 2.4, shpronësimi ndërlidhet në mënyrë të quartë dhe të drejtpërdrejtë me arritjen e njërit nga qëllimet me publikun. Në bazë të nenit 6 paragrafi 2 shkronja f e Statutit të Komunës, thotë: Ofrimi i shërbimeve publike lokale dhe infrastrukturës duke përfshirë, ujë, kanalizimin, përpunimin e ujërave të zeza, mirëmbajtjen e rrugëve lokale, transportin lokal dhe menaxhimin e mbeturinave.

z. Naim Beça: Kryetar dhe anëtarë të KK, duhet të kuptoni një gjë, LVV dega në Kaçanik, nuk është kundër çdo vendimi që e bini ju. Qëllimi është së LVV ka lindur nga gabimet e

juaja 20 vjeçare. Ne të gjithë këta anëtarë të LVV nuk jemi kundër vendimit të këmbimit të pronës në Duraj as të asaj në Biçec, por ne jemi këtu me iu korriguar juve që mos të bëni këso gabime. Udhëheqjen e ka pasur PDK dhe çështja e shpronësimëve kanë me qenë në minimum 1000 shpronësim që kanë me u bërë. Andaj ne po kërkojmë që mos të bëhen të njëjtat gabime. Ne po hezitojmë se keni gabuar, kanë gabuar edhe anëtarët e mëhershëm që i kanë votuar, edhe kryetari e pranojë së keni gabuar, prandaj mos na merrni si negativ, ne jemi parti shumë pozitive, mos mendoni së ne jemi veç kundër, kjo nuk qëndron.

z. Adnan Reka: Ju iu keni referuar Ligjit për shpronësim, nen 4 paragrafi 2. d. m.th. ju po kërkonit një vendim për shpronësim nga KK, ndërkaq vendimin për shpronësim e merr vetëm kryetari i komunës.

Kryetari i Komunës: z. Naim, faleminderit për këshillën e mirë që mos të gabojmë, por nëse ne gabojmë është zyra ligjore e MAPL që na korrigjon vendimet. Ne kemi pasur raste kur kemi marrë vendim për formimin e komisionit për ndarje të banesave të socialit, MAPL na ka kthyer së është e drejtë ekskluzive e kryetarit. Edhe të ky rast, KK po e shpall interes të përgjithshëm këtë pronë, dhe nuk është rasti i parë që merr KK, ndërkaq vendimin për shpronësim e bënë kryetari. Nëse është jo legjitim vendimi, na e kthen MAPL. Tjetra, LVV nga mandati i kaluar asnjë vendim nuk e ka votuar, duke gjetur pretekste e arsyë. Mundem me thënë 95%, përjashtuar disa komisione, LVV kanë qenë abstenim ose kundër, ne nuk kemi thënë asgjë, ndërkaq nuk kanë qenë çdo vendim i pa arsyeshëm. Për parregullsi ligjore është një organ tjetër që na korrigjon. Ne e kemi menduar së kjo është forma, ndoshta ju e dini rrugën më mirë, pastaj e shikojmë vendimin e autoritetit mbikëqyrës qysh na vjen.

z. Adnan Reka: Është e padrejtë dhe e pandershme që thuhet së 95% të vendimeve nuk i ka aprovar LVV. Kjo është e pavërtetë, mundem të argumentoj, Ndërkaq vendimet të padrejta që i keni përligjur përmes KK keni marrë shumë. Edhe në mbledhjen e kaluar e potencuat se juve (kuvendin) nuk iu rrokë ligji, është e vërtetë, por nuk d.m.th. pse neve nuk na rrokë ligji, e juve iu rrokë ligji, e me i kaluar vendime përmes KK, kjo është e padrejtë.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne jemi këtu të subjekteve të ndryshme, dhe është normale mos me menduar njëjtë, por që thoni se prej gabimeve të juaja kemi dalë, atëherë keni me mbetur shumë vite në opozitë, se ne nuk jemi duke gabuar shumë. Në duhet të respektojmë mendimin e secilit si voton qoftë për apo kundër apo abstenim. Respektimi i vendimit të shumicës është parim demokratik.

znj. Ardita Rahmani: Lidhur me mendimin e z. Naim, nëse mundemi me i thënë "akuzë", po të kishim menduar të gjithë njëjtë, do ishim të gjithë në një grup parlamentar dhe nuk do të kishte pluralizëm këtu. Ne si GP nuk kemi obligim me i dhënë llogari asnjë subjekti politik, as kryesuesit, as kryetarit për vendimet të cilat ne i marrim si GP. Ju kisha lutur si Naimit dhe secilit anëtar tjetër që është i përfaqësuar në KK, mos me folur për vendimet që i merr GP tjetër, qoftë i pozitës apo opozitës.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Propozim Vendimin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë i aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 7 anëtarë nga LVV, Abstenime 2, Naim Beça dhe Agim Çaka. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për shpallje me interes të përgjithshëm publik, parcelat kadastrale me numrat: 01306-2 dhe 01306-8, ZK Kaçanik i Vjetër, për shfrytëzimin e hapësirave shkollore/ Lënda: 01Nr. 06-350/02-4729/22.

10. Raporti vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm për vitin 2021;

Kryesuesi i Kuvendit: Zyra e Auditimit e cila është në kuadër të komunës i reporton kryetarit të komunës për të gjeturat e administratës në përgjithësi, mirëpo për shkak të grantit të përformancës po kërkohet të diskutohet raporti edhe në KK. E hapi diskutimin:

znj. Arlinda Rakoci-Raka: Të rapporti i auditorit shihet se kemi një përqindje të ulët të zbatimit të rekomandimeve, 31 %, e që në krahasim më vitin 2020, ka një rënje për 4%. Shpresojmë të merren masa për vitin tjetër, ndërkaq kërkoj sqarim pse kjo përqindje kaq e ulët e zbatimit të rekomandimeve ?

z. Agim Mani: Ky rapport i auditimit të brendshëm në përbledhje të saj pasqyron punën dhe kompetencat e auditimit të brendshëm në komunën e Kaçanikut, ku janë përfshirë aktivitetet e njësisë së auditimit të brendshëm. NJAB është veprimtari këshillëdhënëse, në këtë rast me shumë për të ndihmuar, përmirësuar sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga ky rapport janë dhënë 29 rekomandime, nga to janë zbatuar plotësisht 31%, pjesërisht janë zbatuar 51.72%, ndërsa 17.24 % nuk janë zbatuar fare. Ka pasur edhe të gjetura tjera individuale dhe janë futur në grupe të ndryshme, si dobësi në menaxhim të pasurisë dhe dobësi në menaxhim të projekteve.

Kryetari i Komunës: Faleminderit për sugjerime. Unë jam duke u munduar me i zgjedhur këto rekomandime. Është viti i 6 që marrim nga ZKA për raport pamodifikuar, që na jep mundësinë më hyrë në të gjitha garat, kështu që me sugjerimet e juaja dhe vullnetin tim jam për me i zgjedhur rekomandimet, megjithatë nuk do të thotë që nuk dalin edhe pengesa tjera në vitet në vijim. Sidoqoftë jam falënderues për kritikat, auditorja e ka dhënë verdiktin real qysh është gjendja në komunën e Kaçanikut, megjithatë po mundohem të kemi sa me pak rekomandime ku do të ndiejmë vetën shumë më mirë dhe me pak të kritikuar nga opozita.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatoj së Kuvendi i Komunës u,

Njoftua

Me Raportin vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm për vitin 2021/ Lënda: 01Nr. 470/03-4558/22.

11. Plani i punës së Komitetit për Komunitete, për vitin 2022.

Kryesuesi i Kuvendit: Komiteti i Komuniteteve i formuar nga KK e ka hartuar një plan me pikat të cilat ata mendojnë t'i shqyrtojnë. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim planin dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Me të e Aprovoj Planin e punës së Komitetit për Komunitete, për vitin 2022 / Lënda:
01Nr. 60/01-4551/22.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu që konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora 14:16. Deri në fund të mbledhjes ishin të gjithë anëtarët e KK.

Procesmbajtës
Makfise Malsiu

M. Malsiu



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

K. Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS KAÇANIK
(Legjislatura 7 e Kuvendit të Komunës, të dalë nga Zgjedhjet Lokale të 17 Tetorit 2021)

Evidencia e pjesëmarrjes së anëtarëve të Kuvendit të Komunës në mbledhjen e II-të (Dytë) të Rregullt, mbajtur me 28 shkurt 2022

1	2	3	4	5
Nr. Rend.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Përkatësia politike	Nënshkrimi
01.	Brahim Imishti	Anëtar	PDK	
02.	Hamide Luma	"	PDK	
03.	Kadri Krivenjeva	"	PDK	
04.	Fitore Vishi	"	PDK	
05.	Rrustem Zenuni	"	PDK	
06.	Edon Baftiu	"	PDK	
07.	Selajdin Troni	"	PDK	
08.	Fatmir Bunjaku	"	PDK	
09.	Bashkim Krasniqi	"	PDK	
10.	Florina Lika-Vishi	"	PDK	
11.	Lejla Muhamheri-Çaka	"	PDK	
12.	Agim Mani	"	LVV	
13.	Kadrije Lika-Troni	"	LVV	
14.	Adnan Reka	"	LVV	
15.	Naim Beça	"	LVV	
16.	Raif Kasa	"	LVV	
17.	Ernesta Krasniqi	"	LVV	
18.	Bashkim Luma	"	LVV	
19.	Arta Avdiu	"	LVV	
20.	Ardita Rahmani	"	LDK	
21.	Besnik Salihu	"	LDK	
22.	Betim Shala	"	LDK	
23.	Arlinda Rakoci-Raka	"	LDK	
24.	Rabije Sallahi	"	AAK	
25.	Ekrem Livoreka	"	AAK	
26.	Agim Çaka	"	NISMA	



—

—

—

Vetëtori Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 17 Tetorit 2021);

**Nga Mbledhja e II-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2022,
mbajtur me 28 Shkurt 2022:**

1. Kemal Murseli,
2. Brahim Imishti.....,.....,
3. Hamide Luma,.....,
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Fitore Vishi,.....,.....,
6. Rrustem Zenuni,.....,.....,
7. Edon Baftiu,.....,.....,
8. Selajdin Troni,.....,.....,
9. Fatmir Bunjaku,.....,.....,
10. Bashkim Krasniqi,.....,.....,
11. Florina Lika-Vishi,.....,.....,
12. Lejla Muhamheri-Çaka.....,.....,.....,
13. Agim Mani,.....,.....,
14. Kadrije Lika-Troni,.....,.....,
15. Adnan Reka,.....,.....,
16. Naim Beça,.....,.....,
17. Raif Kasa,.....,.....,
18. Ernesta Krasniqi,.....,.....,.....,
19. Bashkim Luma,.....,.....,
20. Arta Avdiu,.....,.....,
21. Ardita Rrahmani,.....,.....,
22. Besnik Salihu,.....,.....,
23. Betim Shala,.....,.....,.....,
24. Arlinda Rakoci-Raka.....,.....,.....,
25. Rabije Sallahi.....,.....,.....,
26. Ekrem Livoreka.....,.....,.....,
27. Agim Çaka.....,.....,.....,



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

Kaçanik, 15.03.2022

Për: Anëtarët e Kuvendit/ **z.nj. Ardita Rrahmani**
z. Naim Beça

Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe të jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kérkesat tuaja, të parashtuar para Kuvendit të Komunës, më datë, **28.02.2022**

Znj. Ardita Rrahmani

Sipas banorëve të fshatit Ivajë, është bërë njoftimi nga Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Administratës së Përgjithshme për mbylljen e zyres së gjendjes civile në këtë fshat, me arsyetimin se objekti është i vjetruar dhe nuk i plotëson kushtet për të kryer punë administrative si dhe punëtori i kësaj zyreje do të kaloj në komunë. Kérkesë e atyre banorëve është:

Zyreja e gjendjes civile në këtë fshat të mos mbyllt, por të renovohet pasi ketu kryhen shërbime jo vetëm banorët e këtij fshati por edhe të fshatrave për rrithë.

- *Më datën 24.02.2022 kemi mbajtur një takim me administratorin e fshatit Ivajë, në të cilin takim është bërë njoftimi i mbylljes së zyres së gjendjes civile në këtë fshat për arsyet si në vijm:*

1. *Rënia e dukshme e kérkesave për shërbime në këtë zyre, pasi që jan shpërndarur një numër i konsideruhem i banorëve nga ky fshat, dhe shërbimet mund te kryhen tanë më në secilin vend vetem me numër identifikues personal.*
Në periudhen 01.01.2021 - 30.12.2021 kjo zyre ka lëshuar gjithësejë 530 certifikata, numër jashtëzakonisht i ulët në krahasim zyrtët tjerë.
2. *Si dhe certifikatat e nxjerrura nga kjo zyre për të kryer një proces duhet të përcjellen në institucionë tjera (dmth me nxjerrjen e një certifikate lindje në zyren e fsh.Ivajë, për të nxjerrur leternjoftimin duhet te vish në Qendrën për Paisje me Dokumente).*
3. *Duke u bazuar në efikasitetin e punës, ne si institucion kemi paraqitur kérkesën për mbylljen e kësaj zyreje në Agjencionin e Regjistrimit Civil , pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme.*
Ku njëkohësisht kemi marrë pëlqimin nga ky agjpcion, dhe mbështetjen për të vazhduar tutje me këtë procedurë në rastin konkretë .

Duke u mbështetur në arsyet e sipërpërmendura , dhe duke respektuar të drejtën që secili banorë i atij fshati të dijë procesin që po zhvillohet rrithë asaj zyreje, paraprakishtë ne si institucion kemi njoftuar administratorin e fshatit me arsyet e detajuara

Bashkangjitur me përgjigjen, keni edhe raportin e punës të zyrtatrit të zyres së gjendjes civile në fshatin Ivajë, pëlqimin e ARC-së për mbylljen e kësaj zyreje.

z. Naim Beqa,

Pse është kaq ftohtë në këtë sallë, a nuk duhet të ishte me nxeh të?


Inderuar, për arsy që ditët paraprake ishin ditë vikendi dhe në objekt nuk jan ndezur nxemjet qendrore gjithashtu dhe temperaturat e ulëta, edhe pse gjatë ditës për të cilën flasim është ndezur në orët e hershme të mëngjesit nxemja qendrore, kan bërë që salla të mos ketë nxeh tësin e duhur.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,



Dardana Tafili Dauti



Drejtori DAP



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA Kaçanik - OPŠTINA Kaçanik - MUNICIPALITY OF Kacanik

Raporti i gjeneruar mbi gjendjen civile



Përdoruesi: Xhevair.livoreka

Prej: 01.01.2021 Deri: 30.12.2021

Nr.	Dokumenti	Me pagesë	Të liruara nga pagesa	Të anuluara	Totali
1	Certifikata e lindjes	36	13	0	49
2	Certifikata e Martesës	32	11	0	43
3	Certifikata e Shtetësisë	1	1	0	2
4	Certifikata e statusit martesor	19	5	0	24
5	Certifikata e vdekjes	6	8	0	14
6	Certifikata e vendbanimit	7	16	0	23
7	Deklarate e bashekësise familjare	15	14	0	29
8	Ekstrakti i lindjes	251	84	0	335
9	Vërtetim nga arkiva	9	2	0	11
Totali		376	154	0	530



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
GEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVË-GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME-MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS
MINISTERI I UNUTRAŠNJIH POSLOVA-MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS
AGJENCIJA I REGJISTRIMIT CIVIL-AGENCY FOR CIVIL REGISTRATION
CIVIL REGISTRATION AGENCY

Nr. Br. No. 02 Datum/Date 08.02.2022

145



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

AGJENCIA E REGJISTRIMIT CIVIL
AGENCIJA ZA CIVILNU REGISTRACIJU / CIVIL REGISTRATION AGENCY

Drejtorati i Gjendjes Civile / Direkcija Civilnog Stanja / Directorat of Civil Status

LISTË DISTRIBUIMI-CIRKULARNO PISMO-ROUTING SLIP

REFERENCË:	Datë 08/02/2022			
PËR/ZA/TO:	znj. Dardana Tafili Dautaj-DAP			
PËRMES/PREKO/THROUG H:	z. Blerim Camaj, Zëvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm të ARC-ës <i>Blagaj</i>			
NGA/OD/FROM:	Erdon Arifaj, Zëvendësues i Drejtorit të Drejtoratit të Gjendjes Civile			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJEC T:	Përgjigje në kërkesë			
Nr. i zyrës: Br. kancelarije:	201	Loka cioni:	Rr. "Luan Haradinaj" Ndërtesa e ARC	Data: Datum: 08.02.2022

Enderuar,

Në referim të kërkesës tuaj të datës 03.02.2022, Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC), respektivisht Drejtorati i Gjendjes Civile (DGJC), bazuar në kompetencat që ka sipas Ligjit Nr. Nr.04/L-003 për Gjendjen Civile, si organi më i lartë i shërbimit të Gjendjes Civile në Republikën e Kosovës, ju informon se hapja apo mbyllja e një zyre të gjendjes civile, brenda kompetencës territoriale të një Komune, është në kompetencën tuaj, respektivisht në kompetencën e nivelit lokal, Komunës.

Andaj, duke u bazuar në arsyetimin e dhënë, ne mbështesim nismën tuaj, për nxjerrjen e një Vendimi nga Komuna, për mbylljen e Zyrës së Gjendjes Civile në Ivajë.

Po ashtu, të gjitha dokumentet, dosjet, regjistrat e gjendjes civile, si dhe dokumentet tjera që kanë të bëjnë me Gjendjen Civile brenda kësaj zyreje, duhet të evidentohen dhe të zhvendosen/bartën ne zyrën e Gjendjes Civile, ku Komuna vendsos tanë e tutje, qe këto shërbime të ofrohen.

Me respekt,



Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 28.03.2022

Për: Anëtarët e Kuvendit: **znj. Kadrije Lika-Troni,**
znj. Ardit Rrahmani,
z. Naim Beça,
z. Agim Çaka

Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjëm dhe jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtuara para Kuvendit të Komunës, më datë 28. 02. 2022, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

znj. Kadrije Lika-Troni: Të SHMP ‘Feriz Guri dhe Vellezërit Çaka’, ujëmbledhësi është më lartë sesa nivel i asfaltit dhe gjatë reshjeve atmosferike krijohet pengesë e madhe për ngasësit e automjeteve, sepse të pengesa e shpejtësisë mblidhet uji. Është jo etike para SHMP të shihet një punë joprofesionale, kjo paraqet një imazh të keq për institucionin komunal.

- *Në rrugën “Vellezërit Çaka”në afërsi të SHMP ‘Feriz Guri dhe Vellezërit Çaka’ e kemi të evidentuar lokacionin dhe problematikën e akumulimit të ujit nga reshjet atmosferike. Aty nuk ka ujëmbledhës për ujrat atmosferike kështu që me kompaninë që është e kontraktuar për projektin ”Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike” do të punohet ujëmbledhësi dhe përmes gypave do të dërgohet deri te përrocka më e afërt*

znj. Ardit Rrahmani, E ngriti një shqetësim për çështjen e qenve endacak , problem i kamotshëm që po merret secili nga ne, ku komuna deri tani është dashur të ndaj mjete për menaxhimin e kësaj situate. Nuk ka vend që nuk ka qen endacak dhe kjo paraqet rrezik për qytetarët e komunës. Hedhja e fajit nga ai lokal në atë qendror dhe anasjelltas është ndër vite, që po ju sjell pasoja qytetarëve, e që uroj të mos përfundoj me fatalitet, atëherë nuk dihet nga kush me kërkuar llogari. Cilat janë masat konkrete që ka marrë komuna, sepse ky problem është shumë i dukshëm, sidomos në kohën e dimrit?

- *Komuna e Kaçanikut ka ndarë mjete buxhetore dhe ka të kontraktuar kompaninë për implementimin e projekteve “Trajtimi i qenve endacak”. Kontrata është lidhur për periudhën dyvjeçare 2021-2022. Sipas periudhave kohore, kur menaxheri i kontratës e vlerëson duke bazuar në gjendjen dhe kërkesat në teren, kontakton kompaninë dhe kërkon të trajtohen qenët e evidentuar pa pronarë.*

z. Naim Beça

Kur do të përfundojnë projektet të cilat kanë filluar para zgjedhjeve, të cilat kanë mbetur në gjysmë, si: Asfaltimi i rrugës së qytetit, e shumë projekte tjera?

- *Projekti “Reabilitimi i rrugës “Qamil Ilazi” dhe “Sali Bajra”” do të finalizohet në gjashtëmuajorin e parë 2022.*

z. Agim Çaka: E ngriti një shqetësim në vendkalimin për këmbësor në rrugën e magistrale te lagjet: Çaka dhe Zeneli, e cila pjesë e rrugës paraqitet rrezik permanent për këmbësor, andaj drejtoria kompetente duhet të bëjë një zgjidhje të kësaj çështje. Gjithashtu kërkoj të bëhet një zgjidhje për çështjen e ndriçimit publik në atë pjesë.

- *Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave ka të evidentuar dhe do të shqyrtoj mundësitet buxhetore për ndërtimin e një trotuari përgjatë rrugës magjistrale Kaçanik – Hani Elezit, duke filluar nga lagja Çaka dhe Zeneli deri te parkingu i Palestrës së Sportit me qëllim të lehtësimit të qarkullimit të këmbësorëve.*

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,





Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Kaçanik, 25.03.2022

Për: z. Naim Beqa, Këshilltar i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut

Z. Naim Beqa, Këshilltar i Kuvendit të Komunës së kaçanikut në Mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të datës 18.02.2022 ka parashtruar pyetjen:

Lidhur me pyetjen të cilën e kam ngritur për projektin e Prroit në F. Runjevë, nuk kam marrë përgjigje, andaj kërkoj një përgjigje me shkrim.

Z. Naim Beqa ka parashtruar pyetje në lidhje me ecurine e puneve dhe përrregullimin e prronit të Runjeves edhe në Mbledhjen e Kuvendit, në muajin Janar.


Për kete arësy, po edhe duke u bazuar në detyrat dhe perjegjësitë e Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes se Mjedisit, shfrytëzoj rastin që të jap përgjigje dhe sqarime në pyetjen tuaj për kryerjen e puneve, përrregullimin e prroit në Fshatin Runjeve.

- **Rregullimi i Shtratit të Prronit në Runjeve (te Lagjeja Burrniku) është pjesë e tenderit Ndërtimi i shtretërve të lumenjëve dhe përrrockave. Pyetja, përkatesisht vërejtja është bërë për mënyrën e rregullimit te mureve të shtratit në një pjesw të pérroit, nw afwrsi tw pllakws pwrkujtimore tw dwshmorit Kemal Thaqi, ku është paraqitë vërejtja se shtrati po ngushtohet dhe mund të ketë probleme për pranimin e ujit në rastet e vërvshimeve. Kjo nuk paraqet problem sepse shtrati do të ngritet me lart, rrjedhimisht nuk do të zvoglohet kapaciteti i shtratit të pérroit, përkatesisht nuk do të zvoglohet sasia e ujit që mund të përballojë shtrati i pérroit pas rregullimit të tij. Poashtu kishte vërejtje edhe për llojin e gurëve që ishin përdore për atë qëllim. Megjithate pas verejtjeve te paraqituar në Kuvend, guret e shtratit në pjesën e cila ka pase verejtje janë larguar. Pritet që me investimet e këtij viti të përfundojë puna përrregullimin e shtratit te këtij pérroi. Pra do të kryhet puna përrregullimin e këtij shtratit të pérroit, në pjesën e epërmë deri te penda (shkarpa ekzistuese), po edhe në pjesën e poshtme deri te derdhja e tij në Lumin Nerodime. Pjesa e shtratit**

per te cilën është bërë vërejtje do të ngritet. Pjesa e ekzistuese e shtratit do te mbetet, përkatësisht nuk do të mbulohet sepse ajo është e padëmtuar. Poashtu, të njëjtat vërejtje i kishte edhe kjo pjesë e komunitetit të Runjevës.

Ju faleminderit për bashkëpunimin...

Drejtori i DUKMM-së
Qamil Stagova





Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Kaçanik, 30.03.2022

Për: z. Agim Çaka, Këshilltar i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut

Z. Agim Çaka, Këshilltar i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut në Mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të datës 18.01.2021 ka kerkuar informata për projektin Ndërtimi dhe rregullimi i Çarhisë së Vjetër të Qytetit:

Përshëndetje për të gjithë, përshëndetje për drejtoret e rinj që kanë marrë detyrën. Unë kam me ngritur një çështje për kompleksin e qytetit të vjetër, ndërkaoq nuk kam kurrfarë informacioni së cili është projekti, kush është kryesi i punimeve, sa ka kushtuar projekti dhe kush e finançon? A ekziston plan përfundimtar sesi do të duket ky projekt dhe a do të ketë ky kompleks elemente të qarhisë së vjetër? Lidhur me këtë projekt, kërkoi me na ofruar një raport me shkrim.

- Vlera e puneve për realizimin e këtij projekti është 291761.19€. Punët për ndërtimin e Çarhisë i kryen ndermarrja P&I Sh.p.k, e cila është përzgjedhur në bazë të një procedure të rregullt të udhëhequr nga Zyra e Prokurimit.

Afati për kryerjen e punëve është 24 muaj.

Deri më tash janë kryer këto pagesa:

- Avansi	29176.12€
- Situacioni I	28980.90€
- <u>Situacioni II</u>	95015.48€

Gjithsej: 153172.50€

Per perfundimin e puneve, sipas projektit, nevojiten edhe 138588.69€.

Sipas bugjetit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2022 për ndërtimin e Çarhisë janë paraparë 200000.00€.

Pas përfundimit të punëve sipas kontrates do të analizohet se a ka nevoje për pune të tjera, e pastaj mjetet e mbetur mund të orientohen per pune te tjera.

Ju njoftojme se sipas projektit është paraparë edhe zhvendosja e trafos, e cila gjendet ne lokacionin e Çarhisë.

Ju faleminderit për bashkëpunimin...

Drejtor i DUKMM-së
Qamil Stagova



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

DREJTORIA E ARSIMIT

Përgjigje në kërkesën e z. Bashkim Luma,

Të ndryshohen kriteret për bursa të studentëve dhe pjesë e konkursit për bursa të jenë edhe studentët që i ndjekin studimet në shtetet përreth.

Përgjigje: Drejtoria e Arsimit nuk ka kompetencë për t'i ndryshuar kriteret për ndarje të bursave për student por shqetësimin e Juaj do ta përcjellë te Kryetari i Komunës dhe në Kuvend.

Me respekt,
Drejtori Zahir Doda

